



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 971/1 Prot.

Tiranë, më 10.2.2023

URDHËR

Nr. 79, datë 10.2/2023

PËR

**SHPALLJEN E THIRRJES PËR PROJEKT PROPOZIME NË FUSHËN E
SPORTIT, NGA FEDERATAT JOOLIMPIKE PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjit nr. 84/2022 dt.20.12.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe pika 3 e nenit 17 të Ligjit Nr. 79/2017 “Për sportin” të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Shpalljen e thirrjes për projekt propozime në fushën e sportit, nga federatat joolimpike për vitin 2023.
2. Afati i dorëzimit të dokumentacionit aplikues për projekt propozimet, do të jetë deri më datë 24.02.2023.
3. Vlerësimi i projekt propozimeve të federatave sportive joolimpike do të bëhet nga Ministria përgjegjëse për sportin, në përputhje me treguesit e përcaktuar në shtojcat 1 dhe 2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Politikave të Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI

